



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Dt.07.06.2024 Nr.

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 , nenit 80 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Udhëzimit Administrativ nr. 34/2014 funksionimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë, Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Fushë Kosovës shpallë :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës për bashkëpunëtor profesional psikolog

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i pozitave
1	IP	Psikolog	Vend i lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose në web. të Komunës),
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te Noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime,
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit profesional:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar, Ligjit Nr.02/L-52, Ligjit Nr.03/L-068 dhe Ligjit Nr.04/L-138, si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA 34/2014) ,(UA 25/2014) Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

III. Kriteret e kualifikimit për bashkëpunëtor profesional Psikolog :

Niveli Master – dega Psikologji, drejtimi Psikologji shkolllore dhe këshillim -Fakulteti Filozofik (300 ECTS).

Koeficienti : E 18 5.7

Puna provuese : 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës.



Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Psikologut :

- Psikologu kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënit dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të fëmijëve.
- Psikologu ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjitha akteret në IP.
- Psikologu ka për detyrë t'i vlerësoj dhe interpretoj çështje që kanë të bëjnë me procesin e të nxënit dhe zhvillimin kognitiv, social, personal dhe emocional të fëmijëve.
- Psikologu asiston dhe ofron ndihmë në identifikimin e fëmijëve me vështirësi në të nxënë , fëmijëve të talentuar, identifikon dhe vlerëson nevojat e fëmijëve , bashkëpunon me profesionist të tjerë dhe zbaton vlerësime të përshtatshme (të besueshme dhe valide):
- Zhvillon intervista me fëmijë , edukatore e prindër vëzhgime e procedura të ndryshme me qëllim të vlerësimit objektiv dhe propozon e zbaton masa për intervenime psiko edukative individuale dhe në grup-
- Psikologu ka për detyrë të punoi drejtpërdrejt me fëmijët.

VËREJTJE: Sipas Udhëzimit administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 7 paragrafi 25, "Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin arsimor 300 ECTS për disiplinat nga paragrafi 1-24 të këtij neni, në fakultetet tjera përveç Fakultetit të Edukimit, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të UA nr.06/2015 të datës 10.07.2015, i plotësojnë kriteret për punësim". neni 11 paragrafi 3, "Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin para universitar të paraparë në nenin 6 dhe 7 të këtij Udhëzimit administrativ".

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar, sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen. Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim.Procedura e vlerësimit të konkursit publik përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik.

Kandidatët që arrijnë së paku 55 pikë nga testi me shkrim i nënshtrohen intervistimit me gojë. , jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë dhe intervistimi deri në njëzetë (20) pikë.Pikët nga testi me shkrim CV dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidati me më shumë pikë do të përzgjidhet në pozitën e lartcekur.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente dhe jo ato që janë të deklaruara pa dëshmi.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diplomat duhet t'i kenë të nostifikuara nga MASHT-i.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë si dhe orari i intervistës do të publikohen në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2024/25.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur **30 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **07.06.2024 deri me : 06.07.2024**.

Aplikacioni i kompletuar me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohet në Komunë përmes zyrës pritëse në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të proceduarave të konkursit.

Adresa: Objekti i Komunës, rruga Tahir Zemaj nr.2, Fushë-Kosovë.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim

Fatlum Berisha

